



11/Nr. 7296 /2024

DREJTORIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

THIRJE PËR APLIKIM

Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural e Komunës Hani i Elezit në përkrahje të fermerëve për zhvillimit të bujqësisë për vitin 2024 shpallë Thirrjen për aplikim në projektin “Subvencionimi i fermerëve me mekanizëm bujqësor”.

Projekti i subvencionimit të fermerëve me mekanizëm bujqësor do të realizohet me bashkëfinancim nga Komuna dhe fermerëve 20% - 30%.

Fermerët mund të aplikojnë për njërin nga këto pajisje bujqësore: **plug 2 rende, trina 3 krahëshe, shpërndarëse plehu 300 litra dhe spërkatëse 300 litra.**

Kushtet e aplikimit:

- Të jetë banor i Komunës së Hanit i Elezit.
- Pronën ta ketë në territorin e Komunës Hani i Elezit. Duhet të ketë traktor me fuqi që i përgjigjet pajisjes për të cilën aplikon / dëshmohet me librezën traktorit-kopje.
- Fermerë duhet të kenë aplikuar për subvencione-Pagesa direkte për vitin 2024,
- Përparësi kanë fermerët të mbjellur sipërfaqe më të mëdha,
- Përparësi kanë fermerët që nuk kanë qenë përfitues të mekanizmit bujqësorë tri vitet e fundit.

Dokumentacioni nevojshëm për aplikim :

- Fletëaplikacionin e plotësuar për aplikim,
- Kopjen e dokumentit identifikues
- Dëshminë – kopjen e aplikacionin të aplikimit për subvencione direkte për vitin 2024
- Dëshmi për posedimin e traktorit
- Certifikatën e posedimit të pronës bujqësore

Të interesuarit për më shumë informata për aplikim mund të drejtohen në zyrën e DBPZHR-së, në objektin e komunës.

Afati për aplikim fillon nga data **30.08.2024** deri më **20.09.2024**.

Data: 30.08.2024
Hani i Elezit

Drejtori i DBPZHR-së
Abduraman Bushi